

FANTASTIKJA E MITRUSH KUTELIT DHE NIKOLAJ GOGOLIT

Përmbledhje

Bota artistike e Kutelit është një botë, që i ngjan sa realitetit aq dhe fantastikes. Karakteristika e një teksti fantastik nuk është prania e thjeshtë e dukurive ose e qenieve të mbinatyrshme, por është një proces ngurrimi, që ndodh midis tij dhe lexuesit, kur këtij të fundit i duhet të perceptojë ngjarje të paraqitura. Edhe nga Gogoli, fantastikja përdoret me mjeshtëri e me një origjinalitet të veçantë dhe me radhë. Ajo nuk qëndron jashtë jetës së përditshme, por përzihet me të, aq sa nuk e dallon ku është e vërteta e ku nis trillimi.

Për mënyrën si trajtohet materiali, fantastikja na kujton Gogolin, tek i cili shpesh nxjerr kryet rëndom një fantastike qesharake a tragjike njëkohësisht e përrallave, e besimeve popullore. I shpeshhtë si figurë në tekstet e Gogolit është djalli.

Përgjatë historisë, lexuesi e pyet veten (ndonjëherë këtë e bën një personazh, madje edhe vetë protagonistin), nëse faktet e sjella shpalosen me anë shkaqesh të mbinatyrshme, të natyrshme, nëse bëhet fjalë për vegullim apo për realitete.²⁰⁶ Kështu do të shprehej Todorovi në lidhje me raportin që krijojnë tekstet fantastike me lexuesin e tyre. "Ngurrimi në perceptim", sipas tij, lind ngaqë shpesh ngjarja e jashtëzakonshme (pra potencialisht e mbinatyrshme) zhvillohet jo në një mjedis të mrekullueshëm, por në një kontekst të përditshëm, që për ne mund të ngjajë i rëndomtë. Po të shohim rrëfimet "Natë gushti" (Përtej valëve të kohës), "Lugetërit e fshatit tonë", "Natë prilli" (Kapllan Aga i Shaban Shpatës), apo i vdekuri dhe i gjalli, "Rinë Katerinëza", "Kryengritje për lugat", "I pasuri që ish i varfër fort" etj., bindemi

206 Tzvetan Todorov, "Poetika e prozës", Shtëpia e librit, Tiranë 2000, fq. 75-76.

që rrëfimi fantastik i Kutelit është rrjedhimisht rrëfim i një perceptimi që çon në mëdyshje.²⁰⁷ Tregimi *“Rinë Katerinëza”* i shkon mjaft mirë për shtat këtij përshkrimi të përgjithshëm të gjinisë fantastike. Është pjesa më e madhe e dallimeve mes *“dy botëve”* që shkaktojnë ngurrim tek të dy protagonistët e përqaftuar para varrit të hapur:

*“Si do që ta lidhim besën, moj ftujza ime? A vjen ti në atë jetë, a të vij unë këtunë? Për këtu ta lidhim besën, o im zot! Dhe u ngritën edhe lidhën besën, aty në varri i s’ëmës, ndenë dritën e zonjës Hënë. E askush s’duhej të dinte besën, e martesës së tyre!”*²⁰⁸

Dhe tek Tat Tanushi kur përshkruan fytyrën e Kalijes ndodh procesi i ngurrimit:

*“Sepse fytyra e saj vishej në një pah drite si dritë e hënës mbi ujë. Po drita e hënës është pa jetë, kurse drita që mbulonte fytyrën e Kalijes, ish e gjallë. Ajo kish po në atë kohë edhe bukurinë e të vdekurit edhe të të gjallit”*²⁰⁹

Ngurrim kemi edhe te protagonistin e tregimit: *“Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit”*, po nëpërmjet një gjendjeje ndërduzash:

*“Sikur nuk ishte as ditë, as natë - një gjë e përzjerë - e sikur Ago Jakupi ngitej për në mal, aty nga udha e vreshtave. Ish si patë qënë dje e nuk ish si dje - se tjetër dritë kish bota. Ecte edhe dëgjonte ay vetë çapet e veta: bumb, bumb, bumb!”*²¹⁰

Edhe karakteristika të tjera të tekstit, e afrojnë rrëfimin Kutelian me gjininë fantastike në përgjithësi. Për mënyrën si trajtohet materiali, fantastikja na kujton Gogolin, tek i cili shpesh nxjerr kryet rëndom një fantastike qesharake a tragjike njëkohësisht e përrallave, e besimeve popullore. I shpeshtë si figurë në tekstet e Gogolit është djalli. Djalli i këtyre tregimeve është edhe ky qesharak e përrallor, por ka edhe dobësi e vese

207 Aurel Plasari, *“Midis të gjallëve dhe të vdekurve”*, *“Apolonia”*, Tiranë 1995, fq. 40-43.

208 Mitrush Kuteli, tregimi *“Rinë Katerinëza”* në *“Netë Shqiptare”* Shtëpia Botuese *“Naim Frashëri”*, Tiranë 1938, fq. 209.

209 Mitrush Kuteli, *“E madhe është gjëma e mëkatit”*, *“Apolonia”*, Tiranë 1996, fq. 15.

210 Mitrush Kuteli, tregimi *“Qysh e gjeti ago Jakupi rrugën e Zotit”* në *“Netë shqiptare”*, ShB *“N. Frashëri”*, Tiranë, 1938, fq. 58.

njerëzore.²¹¹

*“Ndërkaq djalli iu afrua me ngadalë hënës dhe u mat ta zgjaste dorën që ta kapte, por menjëherë e tërhoqi sikur t’i ishte djegur; atëherë u fryu gishtërinjoe, zuri të tunde këmbët dhe u hodh fluturimthi nga ana tjetër; pastaj prapë u largua dhe e tërhoqi dorën. Por, edhe pse nuk po i shkonte mbarë puna, djalli dinak nuk i la prapësitë”.*²¹²

Këto tekste shfaqin një prirje të theksuar drejt alegorisë, por që nuk bëhet asnjëherë shumë e fortë, sepse ato ruajnë edhe elementet që vijnë nga burimet folklorike, duke e bërë gjithsesi të thjeshtë dhe të kuptueshëm tekstin. Ka raste që në kundërvënien mes të mirës dhe të keqes, sipas Plasarit, na bën që të na lindë pyetja mos kemi të bëjmë me tregime moralizuese, si në rastet *“Qysh e gjeti Ago Jakupi rrugën e Zotit”, “Natë muaji Maji”, “I pasuri që ish i varfër fort”,* por është pikërisht elementi fantastik që e bën tekstin letrar dhe aspak didaktik. Edhe nga Gogoli, fantastikja përdoret me mjeshtëri e me një origjinalitet të veçantë dhe të rrallë. Ajo nuk qëndron jashtë jetës së përditshme, por përzihet me të, aq sa nuk e dallon ku është e vërteta e ku nis trillimi.

*“Kufoma tani qëndronte para tij në të njëjtin vend rrethi dhe ia kishte ngulur ata sy të odekur, që kishin marrë një ngjyrë të gjelbër. Seminaristi fërgëlloi sytë dhe i shkuan mornica në tërë trupin. Duke ulur sytë përmbi libër, zuri t’i lexonte lutjet më zë më të lartë dhe dëgjoi që kufoma prapë kërcellete dhëmbët dhe zgjati krahët për ta kapur”.*²¹³

Në rrëfimet e Kutelit veçohen shkallë-shkallë fanitjet e mbinatyrshe, të zakonshme për tregimin fantastik: vegimi i Ago Jakupit realizohet në tri shkallë të njëpasnjëshme të pasuara nga tri *“zgjime”*.

“Agai u zgjua për të tretën herë, po nuk u zgjua mirë se ëndrra vazhdoi. Sikur ecte në një vapë të madhe, në një rrugë pa hije edhe i digjej shpirti për një pikë ujë. Edhe vuante e gulçonte si jo më keq, sikur

211 Nikolaj Gogoli, parathënja në *“Tregime dhe novela”*, ShB *“Naim Frashëri”*, Tiranë 1987 fq. 5.

212 Nikolaj Gogoli, tregimi, *“Nata para Kërshëndellave”* në *“Tregime dhe novela”*, ShB *“Naim Frashëri”*, Tiranë 1972, fq. 52-53.

213 Nikolaj Gogoli, tregimi, *“Kukudhi”* në *“Tregime dhe novela”* Shtëpia Botuese *“Naim Frashëri”*, Tiranë, 1972, fq. 225.

kish kaluar mbi supe qoftëlargun".²¹⁴

Edhe tek tregimi *"I pasuri që ishte i varfër fort"*, protagonisti, përpara se atij t'i shfaqej vegimi, fle dhe zgjohet plot tri herë.

"Fjeti edhe u zgjua, fjeti edhe u zgjua - tri herë rresht - pastaj fjeti më thellë, sepse trupi i tij ish i lodhur së tepërmi edhe mendja e robëtuar me kamje e skamje e me sterra për ujë".²¹⁵

Ndodh, që rrëfimtari të jetë edhe vetë i pranishëm brenda historisë që rrëfen, si tek rrëfimi *"Përtej valëve të kohës"*, e cila e lehtëson integrimin e lexuesit në universin e subjektit.²¹⁶

Sipas Plasarit, aludimet për të panatyrshmen gjenden të shpërndara gjithandej, rrëfime të tilla shërbejnë si dekor që na parapërgatisin për pranimin e tyre: frushullime gjetesh, zhurmërima krojesh, zënie apo fanitje të befta të hënës, klithma shprese, gjurmë, vaj ulliri, mjaltë blete, dru qiparisi etj. *"Të lugetërit e fshatit tim"* dhe *"Kryengritje për lugat"* Kuteli e mbart këtë *"ghost story"* mbi tone së shumti humoristike, pa e zhvendosur nga qendra elementin fantastik.

"Tani askush nuk çante kokën për të vaditur misrat vetë zoti edhe njerëzia rrinin të shkujdesur në Çuka. Rrinin në Çuka duke pirë duhan e duke folur – ujeme – jo për një lugat që kish dalë në Osnat, jo për një gur që kish rënë nga qielli mbi Shëmbitrin e Pevelanit e jo për një gjarpër që kish dalë e kish folur se iu afrua fundi botës. Gjurma e gjarpërit, dukej në gjithë fletët e trëndafilut të vendit".²¹⁷

Te këto rrëfime (po edhe të tjera) mungesa rreth së cilës na end fantazia e rrëfimitarit shndërrohet në prani. Bëhet fjalë vërtet për lugetër, të cilët, në rrëfime kanë veçoritë e letërsisë gojore: veprojnë si personazhe të mirëfillta, takojnë njerëz rrugëve (sidomos natën) dhe kuvendojnë me ta, u ngulin në sy bashkëbiseduesve *"dy flakë bojë - bojë, me nga gjashtë qoshe"*,

214 Mitrush Kuteli, tregimi, *"Qysh e gjeti ago Jakupi rrugën e zotit"* në *"Netë shqiptare"*, ShB *"N. Frashëri"*, Tiranë, 1938, fq. 59.

215 Mitrush Kuteli, tregimi, *"I pasuri që ish i varfër fort"* në *"Netë shqiptare"*, ShB *"Naim Frashëri"*, Tiranë, 1938, fq. 219.

216 Aurel Plasari, *"Midis të gjallëve dhe të vdekurve"*, *"Apolonia"*, Tiranë 1995, fq. 45-46.

217 Mitrush Kuteli, tregimi, *"Kryengritje për lugat"* në *"Netë shqiptare"*, ShB *"Naim Frashëri"*, Tiranë 1938, fq. 202 -203.

ndezin duhan me eshkë e masat, thyejnë qeramidhe, përmbysin bute, derdhin drithë e prishin qumësht; ata gërvallen, thërrojnë xhama, godasin me shukreta, hyjnë në qymeze e u kthejnë kokën pulave, pëgërin krojet e fshatit, u vënë zjarr mullarëve etj.

*“E sa ishin mbledhur aty në streha mbetën pa frymë, si kufoma. Dëshën të ngrihen e s’ngriheshin dot, dëshën të thërresin e s’thërrisnin dot, se këmbë-gojë e dorë bashkë ua zptoi lugati. Flaka ndenj sa ndenj kështu, pastaj u hepua e u ngrit lart. Një e pa majë çatisë, një majë plepit... E si iku lugait, mezi muar shpirt e u ngritën nga vendi e u kycitën nëpër sëpi. E sikush gjeti atje gjurmët e lugatit: kujt i kish derdhur butet, kujt drithët, kujt qumështin”.*²¹⁸

Pjesa tjetër e personazheve të kësaj galerie fantastike kalojnë përsëri në “këtë botë” nga dashuria: kiroloj vjen për t’iu përgjigjur thirrjes së një vashe (*Rinë Katerinëza*); Zef Shabani kthehet “nga malli i Dafinës” (*Letrat e ndajnatës*); edhe vasha linjë bardhë të katjelit të moçëm, së cilës rrëfimtari ia ndjen mbi ballë “dorën e brylltë”, prej një ndjenjë të tillë kthehet. Të gjitha këto përshkrime, si prani të gjalla, me detaje që ne i dallojmë mirë, si për shembull, ndonjërit petkave u vijnë “era myk”, fytyrën e ka “të tretur”, sytë “të thelluar”.

*“Sa i tretur je, o im zot. Rrobat të kanë marrë myk, fytyra të është tretur edhe sytë thelluar - po je kaq i ëmbël e të dua kaq fort sa s’dua të ndahemi kurrë!”*²¹⁹

Apo një tjetri “i shkon drita tejpertej nëpër trup” dhe bie pak si era dhë e myk.

*“Të tjerët nuk e vinin fort re, se ata kishin gazin e tyre, po ky zot i dasmës e rrihte mendjen si belcat në dërstilë në e kish parë a në s’e kish parë këtë dasmor që i shkonte drita tejpertej nëpër trup e që binte pak si erë dhë e myk”.*²²⁰

Ky vetjaksim i shkrimtarit nuk mund të mos të bjerë në mend formulën e famshme (dhe rremësisht tautologjike) të Henri

218 Mitrush Kuteli, tregimi, “Lugetërit e fshatit tonë” në “Netë shqiptare”, ShB “Naim Frashëri”, Tiranë 1938, fq. 299.

219 Mitrush Kuteli, tregimi, “Rinë Katerinëza” në “Netë shqiptare”, ShB “Naim Frashëri”, Tiranë 1938, fq. 207.

220 Mitrush Kuteli, tregimi, “Natë muaji Maj”, “Netë shqiptare”, ShB “Naim Frashëri”, Tiranë 1938, fq. 228.

Xhejmsit: “prania që ndodhej para tij, ishte e pranishme”. Po “prania e pranishme”, përnjëmend e tejkëqyrëshme nuk ka të përgjigjur. Prandaj t’u kthehemi më mirë konsideratave të Martin Camajt e të kujtojmë se, në rastin kur e pranojmë që ky shkrimtar “nuk i përket asnjë rryme letrare plotësisht” apo “mbetët mik tri ditësh”, vetëm për kalim, kudo të vendosët mbrenda kallepit të-izmave, kjo jo vetëm nuk na pengon, por na vjen në ndihmë për të vënë re se lidhjet e Kutelit me tregimin fantastik aq të theksuara janë, sa domosdoshmërisht i bëjnë sfidë realizmit, së paku një realizmi në kuptimin e tij klasik.

Po të pranojmë parimin sipas të cilit mekanizmi i fshehtë i llojit fantastik qëndron, në ngurrimin e shkaktuar mes një universi (imagjinar) të mrekullueshëm, atëherë mund të pranojmë atë që shprehet Todorovi, se te letërsia fantastike duhet të shohim një fushë të ngushtë, por të privilegjuar nisur prej së cilës mund të nxjerrim hipoteza që lidhen me letërsinë në përgjithësi. Duke e zhvendosur kësaj analizën në qendër të trillimit, Todorovi e zhdruk praktikisht çështjen e realizmit si kategori letrare që specifikon një pjesë të prodhimit letrar: mund të flasim e shumta për shkallë të ndryshme në përdorimin e disa procedimeve etj. Kuteli na paraqitet si një krijues që e paska kuptuar qysh herët (në vitet ’20, kur janë filluar, për shembull, “*I vdekuri dhe i gjalli*”, “*Rinë Katerinëza*” etj., se realizmi të largon në letërsi nga realiteti. Ai mund të ngjasojë sikur ka kaluar nëpër një përvojë “realiste”, por kjo nuk i ka shërbyer vetëm se për të dëshmuar, që realitetin shkrimtari mund ta gjejë vetëm nëpërmjet rrugëve të fantazisë. Tek e rilexojmë prozën tregimtare të Kutelit, një nga mësimet që prej saj mund të nxëmë është se trillimi nuk është i lirë. Trillimi duket i caktuar për të na shpërfaqur realen; të kujtojmë, si shembuj, vegime që kryejnë këtë detyrë të rrëfimit: “*Qysh i gjeti ago Jakupi rrugën e zotit*”, “*Përtej valëve të kohës*”, “*I pasuri që ish i varfër fort*”.²²¹

“Zgjati pastaj dorën – një dorë të thatë e leshtore, (dorë dreqi) - edhe e kapi dreqin dhe e flaku në zjarr e tym, sa ky lebetit me tmerr të madh. Ti në vend të më sjellësh njerëz m’i merr (Ti s’je për mua, se rreh të bëhesh engjëll i bardhë! Edhe bjери t’i biem, sa dridhej shpella gjithë, së

221 Aurel Plasari, “Midis të gjallëve dhe të vdekurve”, “Apolonia”, Tiranë, 1995 fq. 46.

*bashku me maçokët e me bufët që ishim brenda”.*²²²

Paragjykimi i “së besueshmes” duhet cilësuar si një nga paragjykimet që më së shumti e kanë dëmtuar artin. Me tregimin e tij fantastik, Kuteli renditet ndër artistët që shfaqen haptazi kundër një paragjykimi të tillë. “Jeta, - shkruante bashkëkohësi i shkrimtarit tonë, J. Pirandelo, - për të gjitha absurditetet e paftyra, me të cilat shqyrr Zotit është plot, ka privilegjin e paçmuar që të mos ia këtë nevojën asaj besueshmërie së cilës arti është i detyruar t’i bindet.” Absurditetet e jetës kanë nevojë të duken të besueshme, ngaqë janë të vërteta, në kundërshtim me ato të artit që, për t’u dukur të vërteta, kanë nevojë të jenë të besueshme që një shkrimtar si Kuteli e ka pasë njohur mirë një paradoks të tillë, mund të na e vërtetojë këtë edhe fragmenti i mëposhtëm, larg të qenit një trillim, mëton të jetë një regjistrim besnik realiteti në Testamentin që shkrimtari i la gruas së tij: “Mendjen e kam të turbullt nga pagjumësia, nga ëndrrat e këqija. Sikur më ndiqnin gjermanët, që të më varnin. Iknja me vrap, hynja në gropa e puse, dilnja prapë.”²²³

*“Ata më ndiqnin. Ment më kapnin. Iknja përsëri. Në një çast u gjende edhe ti pranë meje. Dhe iknim. Pastaj u ndamë. Fundja, u gjenda i ndjekur nga njerëzit tanë. Prapë gropa, puse, gremina. Sikur isha në Berat, nën Kala. Në një strehë të Kalasë, pranë Kishës. Më tej në Fier. Kisha shpëtuar nga ndjekjet dhe kërkoja ndonjë shtëpi për t’u fshehur. Isha i zbathur, i zhveshur. Dikush me thirri: “Qëndro, Dhimitri! Të zumë!” “Më rrethuan, më zunë dhe po më shpinin të më vrisnin. Unë qeshnja. Kisha qejf të më vrisnin... Dhe ja, u gjenda në burg. Shumë njerëz. Midis tyre Sofo Çomora, që ka vdekur. Më shikonte me dhembje. “Si u bë kështu, o Pasko? Ç’ ke bërë? - S’e di. -Shiko këtu. Dhe më dha ca shkresa të shkruajtura bukur: një akt akuze dhe ca lidhje të tjera. Më quanin “bejtexhi”. Më thoshin se kisha bërë një vjershë për lyren me rima italiane. Pashë Andrean. I ardhi keq. U vendos të më vrasin. Prapë u gëzova. Fundja, do vdes – thashë. --- Do shpëtoj. Do lodhem. Jeta ime ka qënë shumë e turbullt, e ngatërruar, e mirë dhe e keqe. Sa mirë, që mbaroi”*²²⁴.

222 Mitrush Kuteli, tregimi “I pasuri që ish i varfër fort” në “Netë shqiptare”, ShB “Naim Frashëri”, Tiranë 1938, fq. 223.

223 Dhimitër Pasko: Testament (1967) në “Hylli i Dritës”, 3 - 4 1994, fq. 72-73.

224 Aurel Plasari, «Midis te gjallëve dhe të vdekurve », « Apolonia », Tiranë 1995, fq. 51.

Përshtypja e krijuar gjer më sot nga kritika rreth krijimtarisë së Mitrush Kutelit ka qenë ajo e një artisti të qetë, të lidhur që në embrion me mitrën e folklorit, lidhje që nuk iu nda gjatë gjithë jetës; ajo e një prozatori që kënaqet duke thënë e rithënë, si një plakush pranë vatrës, historitë e fshatit të tij të paharruar, që kalimi i kohës ia kishte veshur në fantazi me tisin e përrallave e të legjendave, ajo e një mjeshtri të rrallë të gjuhës që të lë gojëhapur me pasurinë e leksikut, me bollëkun e frazeologjisë popullore, me muzikalitetin e ëmbël, me të cilin ishte në gjendje të pëshkullte çdo fjalë e çdo frazë, të gjitha këto janë patjetër, të vërteta.

Me metodën e tij strukturaliste, Aurel Plasari zbulon sot përpara syve tanë pikërisht këto shenja, një me “invariantet” e tij, na mëson të përdorim kodet e tij dhe të shohim modernitetin e fjalës artistike të Kuteli, mendimet e tij që burojnë nga një filozofi krejt e thjeshtë. Veprat e tij ishin “më të pranueshme”, si rrëfimet “E madhe është gjama e mëkatit”, “I vdekuri dhe i gjalli”, “Rinë Katerinëza”, “Qysh e gjeti ago Jakupi rrugën e zotit”, “Kryengritje për lugat”, “I pasuri që ish i varfër fort”. Kuteli u përpoq, të bënte “të dukshmen të padukshme”.

*“Agai fjeti edhe pa një ëndërr të dytë: Ecte, gjithë rrugës së vreshtave edhe dëgjonte çapet e veta bumb-bumb-bumb. I doli prapë në të bardha me kërrabë në dorë edhe i tha: - O ago Jakup, o ago Jakup, bëj mirë e mbushe këtë thes me dhe. Nisi të të mbushe thesin. Dheu ish i fortë edhe agai u lodh e nisi të gulçojë. Po për të mbushur, e mbushi.”*²²⁵

Ai përpiket të depërtojë në misterin e jetës, misterin që ndan jetën nga mosjeta, të cilat përbëjnë në fund të fundit një entitet (njësi) të vetëm, “realitetin” e vërtetë të qenies.

Aurel Plasari e shqyrton Kutelin si “shkrimtar fantastik”, si rrëfimtar në kërkim të hyjnisë. Në rrëfimet më të arrira të Mitrush Kutelit, tema qendrore është jeta e fshatit shqiptar në të kaluarën, pozita e mjeruar e fshatarit, shtypja dhe padrejtësitë që rëndojnë mbi kurrizin e tij, plagët e mëdha shoqërore.²²⁶

Merita kryesore e shkrimtarit qëndron në faktin se, duke treguar për këtë kohë të errët e të përbindshme, ai afirmon qëndresën e paepur të fshatarëve, si tipari zotërues i tyre. Sipas

225 Mitrush Kuteli, “Qysh e gjeti ago Jakupi rrugën e zotit” në “Netë shqiptare”, ShB “Naim Frashëri”, Tiranë 1938, fq. 58.

226 Nasho Jorgaqi, «Vepër studimore dhe dokumentare», ShB “Naim Frashëri”, botimi i parë, Tiranë, 1979, botimi i dytë, ShB “Dituria” fq. 96 - 97.

Belinskit, gjithçka që mund të këtë të bukur natyra, gjithçka që mund të tërheqë jeta fshatarake e njerëzve të thjeshtë, gjithçka origjinale, tipike që mund të këtë një popull, shkëlqen me lule të shumëngjyrta në këto ëndërrime të para poetike të z. Gogol.²²⁷

Populli qëndron në bazë të metodës krijuese të tyre. Tregimet e Gogolit si dhe të Kutelit i karakterizojnë këto veçori: janë të thjeshta, të zakonshme, të vërteta, të natyrshme, origjinale, të reja. Veçantinë e autorëve e gjejmë tek e zakonshmja, tek ajo që bëjnë njerëzit në jetën e përditshme pa zbulime, pa ndryshime. Në veprën s'ka efekte, s'ka skena, s'ka stolisje dramatike, gjithçka është e thjeshtë dhe e kapshme. Rrethanat janë të zakonshme, ato duken të njohura për lexuesin e kohës së tij, por edhe për lexuesin e kohëve të tjera. Roli i lexuesit është i njëjtë, si te Kuteli dhe te Gogoli hapësira që i lihet lexuesit për interpretim, është subjektive.

*"Pas tre ditësh, Xhaladin Benë e kall, n në varr. Xhixhi - hanemi mori ç'mori e u kthye, me karvan e suvarinj, në paushallëkun e babait. Çifligjet i shiti më vonë. Po Gurija ç'u bë? Ku ta dish?"*²²⁸

Lexuesi i sotëm arrin të futet kaq mirë në këtë ambient sa mund ta plotësojë atë me tipare të tjera. Kjo do të thotë se vendosin marrëdhënie intime me veprën dhe lexuesin. Tregimit *"Mbrëmjet në një fshat afër Dikankës"* janë një tablo e tërë e plotë e jetës shtëpiake të popullit, e gëzimeve të vogla, e hidhërimeve të vogla të tij, ndër të parët që u mrekullua prej tyre ishte Pushkini, poeti i madh i Rusisë i shekullit të 19-të, i cili ishte edhe ndër të parët që zbuloi talentin e Gogolit. *"Ja një gaz i vërtetë, i sinqertë, - shkruante ai lidhur me këto tregime, - pa poza, i shpenguar, i natyrshëm....që na bëri të qeshim ne, që s'kishim qeshur që nga koha e Fonvizinit..."*. Hakmarrjen e gjejmë të përshkruar në dy tregime të dy autorëve, siç është hakmarrja tek tregimi *"Gjomomadhë e Gjatollinj"*, është si një legjendë mbi trimërinë fshatare, legjendë për njerëzit të fortë, që e kanë trimërinë *"Siç ka zogu erën e peshku ujin"*. Hakmarrja e tmerrshme përbën tani një çift me Taras Bulbën, dhe të dy këto tablo të mëdha tregojnë se sa lart mund të ngrihet talenti i z. Gogol, thotë Belinski.

227 V. G. Belinski, "Artikuj kritik", ShB "Naim Frashëri", Tiranë 1977, fq. 45.

228 Mitrush Kuteli, "Vjeshta e Xheladin beut" në "Tregime të zgjedhura", ShB "Naim Frashëri", Tiranë 1972, fq. 177.